

E DREJTA E SECILIT TË QËNDROJË NË NATYRË NË SUEDI

Në Suedi kanë të gjithë njerëzit të drejtë të qëndrojnë në natyrë, pra edhe në tokat private. Këtë ne e quajmë, e drejta e secilit të qëndrojnë në natyrë (sued.allemansrätten). Kjo është një liri me shumë përgjegjësi, e cila mund të përshkruhet me fjalët, mos shqetëso – mos prish. Këtu më poshtë, mund të lexosh shkurtimisht, mbi të drejtën e secilit të qëndrojnë në natyrë. Informacion më i hollësishëm mbi të drejtën suedeze të qëndrimit të secilit në natyrë ka në gjuhën suedeze, angleze dhe gjermane, dhe këto i gjenë në vebfaqen e Entit për përkujdesje të natyrës (sued.Naturvårdsverket) www.naturvardsverket.se. Ekziston edhe një tekst i shkurtër në suedishten e lehtë, mbi të drejtën e secilit të qëndrojnë në natyrë. Ekzistojnë edhe broshura në gjuhën suedeze, angleze dhe gjermane, si përmbledhje informacionesh mbi të drejtën e secilit të qëndrojnë në natyrë.

Të ecësh, ta ngasësh biçikletën dhe ta ngasësh kalin

Ti mund të ecësh, ta ngasësh biçikletën dhe ta ngasësh kalin në natyrë. Por, trualli privat, plantacioni dhe toka tjetër e mbjellur, janë pjesë të ndaluara. Trualli është ajo pjesë më afër shtëpisë, dhe ata që banojnë aty duhet të kenë qetësi. Ti duhet ta mbyllësh derën e kullës së rrethuar, nëse p.sh. ti kalon përmes kullës. Mos e ngasni biçikletën ose kalin në shtigjet ku toka është e butë, ose në pjesët tjera të ndjeshme. Mos e ngasni kalin as në shtigjet e rekreacionit ose në shtigjet e skijimit.

Mjetet motorike dhe rrugët private

Është e ndaluar ta ngasësh veturën, motoçikletën, mopedën si dhe mjetet tjera motorike në terren me toka të zhveshura. Terren është e gjithë toka në natyrë, duke përfshirë shtigjet, shtigjet e rekreacionit, dhe udhët e këmbësorëve. (Lejohet të ngasni skuter të borës vetëm atëherë kur nuk ka rrezik ta dëmtoni pyllin apo tokën e mbuluar me borë. Në disa pjesë, është plotësisht e ndaluar ta ngasni skuterin e borës, apo është e lejuar vetëm në shtigjet e skuterave). Mundet, poashtu, të jetë e ndaluar të ngasni mjetet motorike në rrugë të veçanta/rrugë private. Këto lloj rrugësh janë të shënuara me tabelë/shenjë komunikacioni të ndalesës. Por, lejohet të ecësh dhe ta ngasësh biçikletën në rrugë private.



Tendë dhe furgon

Ti mund të fushosh/ngul çadrën ndonjë ditë në natyrë. Të fushosh më gjatë ose më afër shtëpive, atëherë duhet të marrësh leje nga pronari i tokës. Merr poashtu leje para se ta vendosësh furgonin ose autoshtëpizën përgjatë rrugës së veçantë/rrugës private. Nuk lejohet të futesh në terren me furgonin ose autoshtëpizën, p.sh. në plazh ose në livadhe.

Në ujëra

Ti mund ta drejtosh anijen, ta lidhësh atë përkohësisht me litar, të dalësh në breg dhe të lahesh buzë detit, me përjashtim të afërsisë së shtëpive/stallave. Vini re se ka zona shpendësh të mbrojtura si dhe territor tjetër ku është e ndaluar të qëndrosh në ujëra ose të dalësh në breg. Këto territore janë të shënuara me tabela/shenja.



Peshkim

Ti mundesh lirisht të peshkosh/pa paguar tarifën, me grep, shtizë me grep, dhe me disa mjete të tjera të dorës, përgjatë bregdetit si dhe në pesë liqenet më të mëdhenj të Suedisë. Për të peshkuar në ujërat tjera, duhet të kesh kartelë peshkimi ose leje tjetër. Peshkimi me rrjetë nuk përfshihet nga peshkimi i lirë, si dhe peshkimi me grep, peshkimi duke mashtruar peshkun me diçka si insekte etj si dhe peshkimi duke lundruar e tërhequr nuk është i lirë. Nuk lejohet as peshkimi i salmonit në bregdetin verior të Suedisë.

Qeni dhe gjuetia

Lëri të qetë vendbanimet e shtazëve si dhe vocërrakët e tyre. Ndalohet t' i lëndosh ose t' i shqetësosh shtazët e egra. Qentë nuk guxonin t' i lëshoni zgjidhur në natyrë gjatë periudhës 1 mars - 20 gusht, kur shtazët i kanë pranë voglushët e vet. Edhe gjatë kohës tjetër duhet ta përcjellësh me kujdes qenin kur ti je në natyrë. Në shumë terrene në natyrë, si në ujdhesë dhe në siujdhesë, është e zakonshme që qenin duhet mbajtur lidhur.

Zjarri

Gjatë verës është zakonisht e ndaluar të ndezësh zjarr. Çfarëdo zjarri në natyrë është i ndaluar - pra edhe në ato vende të posaçme për zjarre. Përndryshe, nën kujdesin më të madh, lejohet të ndezni zjarr. Fike zjarrin me kujdes! Mos ndez zjarr drejtpërdrejt mbi shkëmb - se pëlçet shkëmbi!

Kokërra, kërpudha dhe lule

Ti mund të mbledhësh kokërra të egra dhe kërpudha si dhe lule të cilat nuk janë të mbrojtura me ligj. Por, është e ndaluar pa leje të presësh dru ose shkurre, të thesh degë ose rrema, të marrësh lëvore mështekne, ose t' i dëmtosh lisat që rriten.

Merr me vete pislëqet!

Ndalohet të hedhësh ose t' i lësh pislëqet pas teje në natyrë. Xham të thyer, kavanoza, plastikë, litar peshkimi dhe pislëqe të tjera e shëmtojnë natyrën dhe prishin ndjenjën e mirë e të qenunit në natyrë. Këto mund t' i dëmtojnë si njerëzit ashtu edhe shtazët.

Natyra e mbrojtur me ligj

Për ato pjesë të natyrës të cilat janë Park kombëtar dhe Rezervate natyrore, ka rregulla të veçanta, të cilat e kufizojnë të drejtën e secilit të qëndrimit në natyrë. Mund të ketë edhe rregulla tjera lokale, për atë terren në natyrë. Ky është simboli i natyrës së mbrojtur me ligj.



Informacione të tjera

Për informacione të tjera, që të dish më shumë se çka vlen, atëherë duhet në rend të parë t' i drejtohesh komunës tënde.